



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Nr. 077/22
Data. 16.12.2022

Prishtinë, 08 shkurt 2022
Kodi i ZRRE-së: V_1489_2022

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Nenit 25, Nenit 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, Nenit 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, Nenit 47, Nenit 48 dhe 49 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 37 dhe Nenit 38 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Rregullën ZRRE/Nr.15/2017 për vendosjen e të Hyrave të Lejuara Maksimale për Furnizuesin me Shërbim Universal (Rregulla për të Hyrat e FSHU);
- Metodologjinë për Strukturën Tarifore sipas Nenit 20 të Rregullës ZRRE/Nr. 15/2017 për të Hyrat e FSHU;
- Vendimin V_1486_2022 të datës 07 shkurt 2022 për aprovimin e të Hyrave të Lejuara Maksimale për Furnizuesin e Shërbim Universal (FSHU);
- Propozimin e Furnizuesit me Shërbim Universal (FSHU), për tarifën e Furnizuesit me Shërbim Universal, të dërguar më datë 07 shkurt 2022 në ZRRE.

në seancën e mbajtur më 08 shkurt 2022 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHEN** - Tarifat me Pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët me të drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal, që do të mbliidhen nga data 09 shkurt 2022 deri në shqyrtimin e ardhshëm tarifor.
- II. Struktura e Tarifave me pakicë e energjisë elektrike për konsumatorët me të drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal, e cila do të zbatohet nga Furnizuesi me Shërbim Universal (FSHU), është paraqitur në tabelën e mëposhtme të këtij Vendimi:

Tabela: Tarifat me pakicë të Energjisë Elektrike për konsumatorët me të drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal:

Grupi Tarifor	Niveli i tensionit të furnizimit	Elementi Tarifor	Njësia	Koha gjatë ditës	Tarifa
1	35 kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		11.19
		Fuqia e angazhuar	€/kW/muaj		5.85
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	4.92
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh	Tarifë e Ulët	3.16
2	10 kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		4.62
		Fuqia e angazhuar	€/kW		5.04
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	5.73
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh	Tarifë e Ulët	3.69
3	0.4 kV Kategoria I (konsumatorët me energji reaktive)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.57
		Fuqia e angazhuar	€/kW		2.97
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	6.69
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh	Tarifë e Ulët	4.96
4	0.4kV Kategoria II	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.97
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e vetme	8.83
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	10.71
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Ulët	5.30
5	0.4kV matësi 2 tarifor (familjarë)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		1.74
		0-800kWh (Blloku i parë)	€/kWh	Tarifë e Lartë	6.75
			€/kWh	Tarifë e Ulët	2.89
		>800kWh (Blloku i dytë)	€/kWh	Tarifë e Lartë	12.52
€/kWh	Tarifë e Ulët		5.90		
6	0.4kV matësi 1 tarifor (familjarë)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		1.74
		0-800 (Blloku i parë)	€/kWh	Tarifë e vetme	5.32
		>800 (Blloku i dytë)	€/kWh	Tarifë e vetme	10.07
7	0.4kV (familjarë pa matës)	Konsumi i vlerësuar:			
		Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		1.74
8	Ndriçimi Publik	Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë mesatare	6.75
		Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		3.21
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e vetme	9.24
<i>Tarifa e lartë (ditë) aplikohet prej orës 07:00 - 22:00 gjatë periudhës 1 tetor deri më 31 mars</i> <i>Tarifa e lartë (ditë) aplikohet prej orës 08:00 - 23:00 gjatë periudhës 1 prill deri më 30 shtator</i> <i>Konsumatori ngarkohet me energji reaktive mbi atë të lejuarën që korespondon me $\cos(\Phi) < 0.95$</i>					

III. Ky vendim do të zbatohet nga Furnizuesi me Shërbim Universal (FSHU), duke filluar nga data 09 shkurt 2022 deri në shqyrtimin e ardhshëm tarifor.

ARSYETIM

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) më datë 13 dhjetor 2021 ka iniciuar Shqyrtimin e Jashtëzakonshëm të të Hyrave të Lejuara Maksimale për operatorët e rregulluar, duke përfshirë edhe Furnizuesin me Shërbim Universal (FSHU). Paralelisht me këtë proces, ZRRE ka inicuar edhe rishikimin e strukturës tarifore për konsumatorët familjar.
- ZRRE sipas njoftimit të saj, ka vlerësuar se ekzistojnë argumente të qarta dhe në bashkërendim me procesin e fundit tarifor ka konstatuar se ka indikacione të tejkalimit të pragut të materialitetit prej 5 % në të Hyrat e Lejuara Maksimale të operatorëve të rregulluar të energjisë elektrike.
- ZRRE në vazhdimësi ka monitoruar situatën e furnizimit me energji elektrike dhe nga analizat e bëra, ka konstatuar se si pasojë e mbizotërimit të çmimeve të larta të energjisë elektrike në bursat ndërkombëtare, është rrezikuar siguria e furnizimit për konsumatorët fundorë me energji elektrike. Duke qenë se kostot e blerjes së energjisë me shumicë janë jashtë kontrollit të operatorëve, konform kornizës ligjore të rregullimit, ZRRE ka iniciuar shqyrtim të jashtëzakonshëm të HLM për operatorët e rregulluar, me qëllim të ruajtjes së sigurisë së furnizimit për konsumatorët e energjisë elektrike dhe reflektimit të kostove të furnizimit.
- Prandaj, mbështetur në kornizën ligjore në fuqi, ZRRE ka hapur shqyrtimin e jashtëzakonshëm të të Hyrave të Lejuara Maksimale për Furnizuesin e Shërbimit Universal (FSHU).
- ZRRE më datë 23 dhjetor 2021 nga Operatorit Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (OST/OT) ka pranuar aplikacionin për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm të Hyrave të Lejuara për Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Tregut.
- ZRRE më datë 28 dhjetor 2021 nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) ka pranuar aplikacionin për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm të Hyrave të Lejuara Maksimale për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes.
- ZRRE më datë 28 dhjetor 2021 nga Furnizuesi me Shërbim Universal (FSHU) ka pranuar aplikacionin për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm të Hyrave të Lejuara Maksimale për Furnizuesin me Shërbim Universal.
- ZRRE më datë 17 janar 2022 ka publikuar Raportin Konsultativ-Shqyrtim i Jashtëzakonshëm i të Hyrave të Lejuara Maksimale të Energjisë Elektrike për Operatorët e Rregulluar, dhe Raportin për strukturën tarifore për konsumatorët e rregulluar të energjisë.
- Raporti Konsultativ ka paraqitur qëndrimet e ZRRE-së për shqyrtimin e jashtëzakonshëm të HLM për të mbuluar ndryshimin e ndjeshëm në kostot e blerjes së energjisë elektrike dhe për të garantuar sigurinë e furnizimit me energji elektrike për konsumatorët. Raporti është vënë në diskutim publik me synimin që të marrë komentet e palëve të interesit për propozimet e ZRRE-së.
- ZRRE më datë 17 janar 2022 ka publikuar Raportin Konsultativ-Shqyrtimi i Strukturës Tarifore për Konsumatorët e Rregulluar të Amvisërive të shërbyer nën FSHU.
- Raporti konsultativ ka paraqitur qëndrimet e ZRRE-së, për ristrukturimin e tarifave të nevojshme për të përmbushur kostot e blerjes së energjisë elektrike dhe për të rivendosur furnizimin me

energji elektrike për konsumatorët, shqyrton shkallën në të cilën struktura aktuale e tarifave ka çuar në një rritje joefikase të kërkesës për energji elektrike dhe propozon struktura tarifore alternative të cilat mund të nxisin konsumin efikas ndërsa duke ruajtur nivelet e njëjta tarifore për konsumatorët efikas.

- ZRRE nga palët e interesit ka pranuar komente duke përfshirë operatorët e rregulluar të sektorit të energjisë elektrike, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, Konsumatorët individual, Zyra e Presidentes së Republikës së Kosovës, INDEP, Balkan Green Foundation – BGF, Shoqata e Mullisëve të Kosovës, Komentet e LDK-së, GP LVV, Komentet e AAK-së, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe kërkesa nga Komuna Obiliqit.
- ZRRE gjatë shqyrtimit publik i ka trajtuar të gjitha komentet e palëve të interesit, dhe të gjithë atyre që kanë dërguar komente në ZRRE, të cilat i ka përfshirë në Raportin përfundimtar për të Hyrat e Lejuara Maksimale për operatorët e rregulluar dhe strukturën tarifore nën FSHU.
- ZRRE pas analizimit dhe vlerësimit ka publikuar Raportin Përfundimtar të Shqyrtimit të Jashtëzakonshëm të Hyrave të Lejuara Maksimale për operatorët e rregulluar, përfshirë edhe të operatorit FSHU, duke përfshirë vlerësimet përfundimtare dhe përgjigjet në komente të palëve të interesit dhe të njëjtin e ka publikuar në faqen zyrtare të ZRRE-së.
- Bordi i ZRRE-së, me datë 07 shkurt 2020 përmes Vendimit V_1486_2022 ka aprovuar të Hyrat e Lejuara Maksimale që do të mbulohej nga Furnizuesi me Shërbim Universal (FSHU), që do të mbledheshin nga FSHU përmes tarifave me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar.
- Të Hyrat e Lejuara Maksimale të Furnizuesit me Shërbim Universal që mbulohej nga tarifat me pakicë të energjisë elektrike për periudhën relevante tarifore të vitit 2022 do të jenë 347,282,520 Euro.
- Tarifat e propozuara nga i licencuari FSHU duhet ndjekur parimet e vendosura në Rregullën ZRRE/Nr.15/2017 për Vendosjen e të Hyrave për Furnizuesin me Shërbim Universal (Rregulla për të Hyrat e FSHU).
- FSHU sipas këtij Vendimi udhëzohet t'i përgatisë dhe dorëzojë në ZRRE propozimin për aprovim të tarifave të rregulluara me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët me të drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal.
- ZRRE më datë 07 shkurt 2022 ka pranuar nga FSHU, propozimin për Tarifat me pakicë të Energjisë Elektrike për konsumatorët me të drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal.
- Propozimi i FSHU-së për tarifat e konsumatorëve me të drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal, është i bazuar në vendimin e ZRRE-së për të Hyrat e Lejuara Maksimale për FSHU, V_1486_2022 të datës 07 shkurt 2022.
- ZRRE, tarifat i ka kalkuluar në pajtueshmëri me Rregullën ZRRE/Nr.15/2017 për të Hyrat e FSHU-së, konkretisht me Kreun VII - Metodologjia për Strukturën Tarifore të nxjerr nga Bordi i ZRRE-së.

- Tarifat reflektojnë kostot e përgjithshme të furnizimit të konsumatorëve me të drejtën e Furnizimit të Shërbimit Universal, ku përfshihen kostot e energjisë elektrike me shumicë, kostot e rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes dhe kostot direkte të FSHU-së.
- Tarifat me pakicë për konsumatorët me të drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal janë të kategorizuara sipas grupeve tarifore në pajtueshmëri me dispozita ligjore të Rregullës për të Hyrat e FSHU-së, përkatësisht me Nenin 20 të Metodologjisë për Strukturën Tarifore, mbi bazën e së cilës mundësohet që secili grup tarifor të bartë kostot e shkaktuara.
- ZRRE me rastin e përcaktimit të tarifave me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët me të drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal, ka marrë parasysh edhe propozimet që janë dhënë në Raportin Përfundimtar për Strukturën Tarifore të konsumatorëve të Rregulluar të Energjisë Elektrike.
- ZRRE gjatë procesit të shqyrtimit të jashtëzakonshëm të tarifave, ka përditësuar vlerat hyrëse për FSHU, për të siguruar që të hyrat e lejuara do të mbulojnë kostot e arsyeshme të ofrimit të shërbimit, të cilat i ka prezantuar në raportet konsultative për të Hyrat e Lejuara Maksimale për operatorët e rregulluar dhe për Strukturën Tarifore.
- Raporti Konsultativ për Strukturën Tarifore, i publikuar nga ZRRE më 17 janar 2022, ka pasur për qëllim të ofrojë propozimin e ZRRE-së për strukturën tarifore dhe nivelin e tarifave të nevojshme për mbulimin e kostove të shërbimit. ZRRE kishte potencuar rritjen e ndjeshme të konsumit të energjisë elektrike në Kosovë dhe kishte analizuar ndërlidhjen në mes të rritjes së konsumit të energjisë dhe ndryshimin e strukturës tarifore në vitin 2017.
- Struktura tarifore e aplikuar nga viti 2017 kishte zvogëluar nxitjen për efikasitet të energjisë që më parë stimulohej nga Bllok-Tarifa Progresive e cila siguronte që një sasi e caktuar e energjisë elektrike të konsumohet me çmim më të ulët ndërsa blloqet e sipërme të reflektojnë koston e ofrimit të asaj energjie në sistem.
- Ndryshimi i strukturës tarifore i vitin 2017 ndikoi në rritje të paqëndrueshme të konsumit të energjisë elektrike në vend. Vëllimi i energjisë elektrike të konsumuar në vitin 2021 ishte 41% më i lartë se ai i vitit 2017. Rritja e konsumit të energjisë u shoqërua edhe me rritje rekorde të ngarkesës maksimale të pikut, që mbingarkoi rrjetin dhe uli aftësinë e kapaciteteve të rrjetit për të liferuar këtë energji elektrike tek konsumatorët.
- Rritja e konsumit të energjisë elektrike ka rezultuar në rritjen e kërkesave për investime kapitale dhe rritjen e koston së blerjes së energjisë elektrike.
- Ndërsa si propozim fillestar ZRRE ka propozuar rivendosjen e strukturës tarifore me bllok-tarifë progresive për të reflektuar më saktë ndryshimin në mes të koston së energjisë së kapaciteteve vendore dhe koston së energjisë së importuar. Madhësia e bllokut ishte propozuar të jetë 600 kWh, e përlogaritur si raporti në mes të energjisë së prodhuar nga kapacitetet vendore (Korporatës Energjetike të Kosovës) dhe numrit të konsumatorëve të furnizuesit të shërbimit universal. Çmimi i energjisë për bllokun e parë të konsumit (nën 600 kWh) do të reflektonte koston mesatare të ofrimit të kësaj energjie nga kapacitetet vendore ndërsa çmimi mbi bllok (mbi 600 kWh) do të reflektonte më saktësisht faktin që kjo energji duhet të importohet prandaj dhe tarifa e këtij blloku do të reflektonte çmimet e importit.

- ZRRE, ka pranuar komente nga palët e interesit gjatë periudhës së konsultimit publik, të cilat i ka trajtuar me shumë kujdes, duke i vlerësuar dhe analizuar secilën veç e veç, duke paraqitur argumentet dhe duke ofruar të dhëna të reja të cilat mund të mos ishin marrë parasysh gjatë propozimit fillestar.
 - ZRRE në Raportin përfundimtar për strukturën tarifore ka paraqitur propozimin final për nivelin e tarifave që do të aplikohen nga data 09 shkurt 2022 – 31 mars 2023 dhe që janë të nevojshme për të mbuluar të Hyrat e Lejuara Maksimale për FSHU.
 - ZRRE ka sqaruar që tarifat që reflektojnë koston reale të furnizimit pa subvencion të Qeverisë së Republikës së Kosovës, e që do të duhet të gjenerohen nga tarifat e rregulluara për të mbuluar koston e shërbimit të energjisë elektrike janë vlerësuar të jenë 447 milionë euro.
 - Në skenarin e pa-subvencionuar, sipas rekomandimit fillestar të ZRRE-së dhe rritjen e bllokut në 800 kWh në muaj, mbulimi i kësaj kostoje do të kërkonte: 1) Rritje prej 21% të komponentëve të energjisë të tarifave të konsumatorëve jo-familjar (biznesorë); 2) Rritje prej 21% të tarifave të energjisë së konsumatorëve familjar për nivelin e konsumit deri në 800 kWh; dhe 3) Aplikim të tarifës prej 0.21 €/kWh për energjinë e konsumuar në kohën e tarifës së lartë dhe 0.09 €/kWh për energjinë e konsumuar në tarifën e ulët për konsumin mbi 800 kWh në muaj (për periudhë mujore të faturimit). ZRRE ka theksuar se kjo ndryshon nga propozimi fillestar i ZRRE-së sipas të cilit, nëse blloku vendoset në 600 kWh, rritja për konsumatorët jo-familjarë dhe konsumatorët familjar deri në 600 kWh ishte vlerësuar të jetë 9%.
 - ZRRE në propozimin përfundimtar për tarifat e energjisë elektrike me pakicë ka marrë parasysh alokimin e subvencionit shtesë prej 10 milion euro sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.05/55 të datës 21.01.2022, si dhe vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për subvencionim prej 90 milion euro shtesë sipas vendimit Nr.01/60 i datës 05.02.2022.
 - Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit dhe analizimit të propozimit për tarifat e Furnizuesit me Shërbim Universal nga FSHU, ka vlerësuar që propozimi i FSHU-ës për strukturën tarifore, nuk reflekton në nivel të arsyeshëm koston e shërbimit sipas kategorive të konsumatorëve dhe nuk ka ofruar nxitje për shfrytëzim eficient të energjisë elektrike.
 - Prandaj ZRRE ka propozuar Bordit të aprovojë strukturën tarifore, e cila reflekton drejtë koston e shërbimit sipas kategorive të konsumatorëve si dhe ndër të tjera përmban elemente të nxitjes së shfrytëzimit eficient të energjisë elektrike, ashtu sic kërkohet me kreun VII të Rregullës për të Hyrat e FSHU-së. Sipas të dhënave të shitjeve të energjisë elektrike, mbulimi i kostove pas subvencionit do të nënkuptonte aplikim të tarifave si në vijim: a) Rritje prej 0% të komponentëve të energjisë elektrike të tarifave të konsumatorëve jo-familjarë; b) Rritje prej 0% të tarifave të energjisë elektrike për konsumatorët familjarë për nivelin e konsumit deri në 800 kWh për periudhë mujore të faturimit; dhe c) Aplikim të tarifës prej 0.1252 €/kWh për energjinë elektrike të konsumuar në kohën e tarifës së lartë dhe 0.059 €/kWh për energjinë e konsumuar në tarifën e ulët për konsumin mbi 800 kWh për periudhë mujore të faturimit.
- IV. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, tridhjetë (30) ditë, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

~~Bozë~~ ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtar

Gan Buçaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Furnizuesit me Shërbim Universal (KESCO SH.A),
- KEDS,
- KOSTT, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.